VENDIM
Nr. 8, datë 11.1.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "STUDIM PROJEKTIM MBIKALIMI I FLLAKËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Studim projektim Mbikalimi i Fllakës".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", "truall" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 43 411 546 (dyzet e tre milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë*)* lekësh.
4. Masa e shpërblimit për pronarët që shpronësohen është 43 411 546 (dyzet e tre milionë e katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e gjashtë*)* lekë dhe do të përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE PËRFUNDIMTARE E PRONARËVE, TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "STUDIM PROJEKTIM MBIKALIMI I FLLAKËS"

	PRONARI			TË DHËNAT (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM SIPAS LLOJIT TË PASURISË													
								Shpronësim tokë "arë"			Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë banimi (shtëpi)			Ndërtesë jo banimi				
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale m²	Sip. m²	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Sip. (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lekë)	Sip. ndërt. konf. ZVRPP (m²)	Çmimi sh/blerje d/m²	Vlera (lek)	Sip. nd. konf. nga ZVRPP-ja (m²)	Vlera e preventivit (lek)	Ndërtesë total Sip. nd konf. nga ZVRPP-ja (m²)	VLERA TOTALE	SHËNIME
1	AGIM	REXHEP	NEZA	2574	159/14	arë	1500	179	227	40,633.00										40,633.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	ASLLAN	REXHEP	NEZA	2574	159/15	arë	500	57	227	12,939.00										12,939.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	BESNIK	REXHEP	NEZA	2574	159/16	arë	1254	181	227	41,087.00										41,087.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
4	FADIL	SULEJMAN	NEZA	2574	159/17	arë	2280	255	227	57,885.00										57,885.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	RIZA	BAJRAM	NEZA	2574	159/18	arë	1234	151	227	34,277.00										34,277.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	REXH	HASAN	NEZA	2574	159/19	arë	1706	254	227	57,658.00										57,658.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	FERIZ	HASAN	NEZA	2574	159/20	arë	1500	261	227	59,247.00										59,247.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	MEHMET	ALI	DEMA	2574	159/21	arë	980	193	227	43,811.00										43,811.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
9	MEHMET	ALI	DEMA	2574	159/22	Arë + truall + ndërtesë	1670				270	335	90,450.00				539.00	15,571,678		15,662,128.00	Konfirmuar nga ASHK-ja rivihet në hip. ligjore në favor të ProCredit
10	MEHMET	ALI	DEMA	2574	159/192	Truall+ ndërtesë	750				180	335	60,300.00	90.88	43,875.00	3,987,360.00	36.00	860,494.00	126.88	4,908,154.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	RUSTEM	HAXHI	NEZA	2574	159/32	arë	355	116	227	26,332.00										26,332.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	AGIM	REXHEP	NEZA	2574	159/31	arë	456	177	227	40,179.00										40,179.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
13	BESNIK	REXHEP	NEZA	2574	159/30	arë	304	115	227	26,105.00										26,105.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
14	FADIL	SULEJMAN	NEZA	2574	159/29	arë	456	176	227	39,952.00										39,952.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
15	DAN	HAZIR	NEZA	2574	159/28	arë	254	122	227	27,694.00										27,694.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
16	REXH	HASAN	NEZA	2574	159/27	arë	304	130	227	29,510.00										29,510.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
17	FERIZ	HASAN	NEZA	2574	159/26	arë	355	125	227	28,375.00										28,375.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
18	FADIL	SYL	NEZA	2574	159/25	arë	250	162	227	36,774.00										36,774.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
19	MEHMET	ALI	DEMA	2574	159/23	arë	406	27	227	6,129.00										6,129.00	
20	RIZA	BAJRAM	NEZA	2574	159/24	arë	102	51	227	11,577.00										11,577.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
21	MUSTAF	ADEM	NEZA	2574	159/44	arë	304	187	227	42,449.00										42,449.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
22	SHKELZEN	SADIK	NEZA	2574	159/45	arë	206	162	227	36,774.00										36,774.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
23	AHMET		NEZA	2574	159/143	arë	900	108	227	24,516.00										24,516.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
24	DAN		NEZA	2574	159/142	arë	1335	169	227	38,363.00										38,363.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
25	SHEFQET		NEZA	2574	159/146	arë	1618	83	227	18,841.00										18,841.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
26	SHKUMBIN	SADRI	BULICA	3852	344/41	Arë	3000	32	339	10,848.00										10,848.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Mbi këtë pas. ndodhet ndërtesa nr. 344/101-ND
27	BP (SMOQI, META, DOMI)			3852	344/77	Truall	4987				298	549	163,602.00							163,602.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
28	AGRON	HALIT	DAJA	3852	14/57	Arë	3935	318	339	107,802.00										107,802.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Vihet në favor të Banka Amerikane e Investimeve
29	IMPULS		SHA	3852	14/59	Truall	2804				814	549	446,886.00				150.75	20,558,786	150.75	21,005,672.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Vihet në favor te "Aplpha Bank" sh.p.k.
30	ASLLAN	ALLAMAN	GASA	3852	14/47	Arë	580	11	339	3,729.00										3,729.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
31	ASLLAN	ALLAMAN	GASA	3852	14/55	Arë	2661	401	339	135,939.00										135,939.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
32	ALI		MAMICA	3852	14/78	Arë	2121	221	339	74,919.00										74,919.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
33	BASHKEPRONARET		MAMICA	3852	14/81	Arë	1629	159	339	53,901.00										53,901.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
34	MEMLI	ALI	MAMICA	3852	14/128	Arë	2000	190	339	64,410.00										64,410.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
35	ARJAN KLARITA	RESHIT RIZA	TIVARI TIVARI	3852	14/130	Arë	1500	74	339	25,086.00										25,086.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Vihet në H/L në favor të OTP Banke
36	BASHKIM	FADIL	BALLA	3852	14/131	Arë	5420	128	339	43,392.00										43,392.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
37	MUSA		MEMA	3852	14/88	Arë	8324	358	339	121,362.00										121,362.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
38	SHOQERIA	THERMO-SWISS	SHA	3852	14/119	Truall	4744				276	549	151,524.00							151,524.00	Konfirmuar nga ASHK-ja Vihet në H/L në favor të Raiffeisen Banke
39	DIANA ARDIAN LLAZAN		Sofka(BARDHI) BARDHI TATI	3852	14/75	Arë	1788	27	339	9,153.00										9,153.00	
40	DIANA ARDIAN		BARDHI BARDHI	3852	14/76	Arë	10949	180	339	61,020.00										61,020.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
41	ZYHDI	OSMAN	LAÇI	3852	14/15	Arë	7880	82	339	27,798.00										27,798.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
	SHUMA		TOTALE																	**43,411,546.00**	